



REPUBLICA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOŠOVA  
MINISTRI E ARSIMIT,  
SHËNDEJES  
DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI  
"HAXHI ZEKA"  
PEJË

REKTORATI

Br. / No. 340 Nr. i faq./ Br. str. / No. pp. 3

Data / Datum / Date: 15.02.2023 Pejë / Peë

Nr./Br.Prot. 21/2023-01

Nr.Faq./Br.Str. 03

Data/Datum: 15.02.2023

SHSKUK  
Shërbimi Spitalor dhe Klinik  
Universitar i Kosovës

Nr. Prot. 340/2023

15.02.2023

SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS  
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova - Hospital and University Clinical  
Service of Kosovo  
Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor –  
Profesionalna Sluzba za Mentalno Zdravlje – Peç  
Professional Mental Helth Services – Pejë

Dhe

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" NË PEJË

Lidhin

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

*Raportimet për problemet e caktuar të shëndetit mendor të studentëve në përgjithësi kanë qenë në rritje. Pasojat të cilat i ka shkaktuar COVID 19, krizat ekonomike e sociale, në mënyrë të veçantë demotivimi i të rinjve për lëmin e studimet e kanë ndërgjegjësuar menaxhmentin e Universitetit "Haxhi Zeke" në Pejë për të krijuar një kuadër një formë të re me efektive e cila do t'u ndihmonte studentëve të vet përmirësimin dhe mirëqenien e shëndetit mendor. Ndikimi i faktorëve të caktuar siç mund të jetë depresioni, ankthi, stresi dhe presioni mund të ndikojnë që studentët të mos përfitojnë mjaftueshëm në procesin akademik në UHZ.*

*Universiteti "haxhi Zeka" në kuadër të Planit Strategjikë ka vendosur parimin me studentin në qendër si bazë e zhvillimit akademik. Prandaj, njëra ndër arsyet thelbësore të UHZ –së është shëndeti i studentëve. Duke u nisur nga këto premisa UHZ synon të punojë ngushtë me profesionistë të kujdesit shëndetësor;*

## Palët:

1. Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor në Pejë, i përfaqësuar nga Dr. Nysrtet Pepaj Drejtor (në tekstin e mëtejme Shërbimi profesional) dhe
2. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, i përfaqësuar nga Prof.Dr. Armand Krasniqi – Rektor (në tekstin e mëtejme UHZ)

## QËLLIMI I MEMORANDUMIT

1. Qëllimi i këtij memorandumi është të rregullojë mënyrën e angazhimit të Shërbimit Profesional të Shëndeti Mendor në Pejë në kuadër të ambienteve të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë për tu ofruar studentëve të këtij universiteti informata promovuese dhe vetdijësuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit mendor;
2. Shërbimi profesional për studentët e UHZ –së, sipas nevojës që kanë, do të jetë në gjendje që në hapësirat e UHZ ose të Shërbimit Profesional Mendor, të ketë angazhime të caktuara psikologjike për të ndihmuar në tejkalimin e problemeve eventuale të cilat lidhen me shëndetin e tyre;
3. Shërbimi profesional do t'u ndihmojë grupeve profesionale të UHZ –së me rastin e hartimit të pyetësorëve të cilët kanë të bëjnë me përcaktimin e faktorëve de motivues gjatë studimeve dhe hartimin e dokumenteve me masat për të rritur motivimin;

## Fushë veprimtaria e aktiviteteve të cilat mund t'i ndërmer Shërbimi Profesional:

- o Të ofrojë trajnime të organizuara për studentët për të shpjeguar rolin e Shëndetit Mendor;
- o Të ofrojnë përkrahje dhe trajtim në aspektin e mirëqenies psikologjike ndaj studentëve;
- o Sipas nevojave dhe dakordimit me ta, të punojnë me studentë në baza individuale dhe të përcjellin mirëqenien psikologjike të tyre;
- o Sipas nevojës, të punojnë dhe të iniciojnë aktivitete grupore me studentë me qëllim të caktuar motivimi;
- o Të koordinojnë dhe të identifikojnë nevojat sociale të studentëve dhe të informoi punëtorin social dhe menaxhmentin e UHZ –së, në mënyrë që universiteti, me masa të caktuara, të intervenoi kurdo që të jetë e nevojshme;
- o Të bëjnë dhe përcjellin gjendjen e përgjithshme shëndetësore apo të problemeve tjera shëndetësore të studentëve;
- o Mundësisht, të identifikohen nevojat sociale të studentëve dhe të informohet e të bashkëpunohet me UIHZ për intervenimet e nevojshme;
- o Të bashkëpunoi me stafin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës për implementimin e trajtimeve gjithëpërfshirëse të studentëve;
- o Të respektoi kodet e etikës në aspektin e konfidencialitetit gjatë praktikës;
- o Të përkrahë që studentët të jenë në gjendje të i gëzojnë të drejtat njerëzore;
- o Detyra të tjera të përcaktuara nga drejtori i Qendrës Shëndetit Mendor në UHZ.



## DETYRIMET E UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA"

1. UHZ do bashkëpunojë ngushtë me Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor në Pejë, që të hartojë planin dhe orarin e ligjëratave të cilat ky shërbim do t'i realizojë në ambientet e UHZ –së;
2. Prorektori për mësim dhe çështje të studentëve do të jetë koordinatori i të gjitha aktiviteteve të planifikuara të cilat Shërbimi Profesional do t'i realizojë në UHZ;
3. UHZ do t'i ofrojë pa asnjë rezervë Shërbimi Profesional të Shëndetit Mendor në Pejë të gjitha mjete e nevojshme teknike për të realizuar ligjëratat;
4. UHZ, mbi bazën e planit të punës me Shërbimi Profesional, do t'i sigurojë ambiente e përshtatshme për realizimin e ligjëratave;
5. UHZ do të bashkëpunojë ngushtë me Parlamentin e Studentëve dhe më Këshillat e studentëve në njësi akademike për përfshirje sa më të madhe të studentëve në ligjëratat;
6. UHZ së bashku me Parlamentin e Studentëve dhe Këshillat e studentëve në njësi akademike do të angazhohen për shpërndarjen eventuale të materialeve promovuese të cilat Shërbimi Profesional i konsideron të nevojshme për distribuim;
7. UHZ – ja do të publikojë në web zyrtarë të gjitha materialet dhe informatat e Shërbimit Profesional të cilat vlerësohen me rëndësi për studentë, personalin e UHZ –së dhe popullatës në përgjithësi;
8. UHZ do t'i ndërmarr të gjitha masat dhe veprimet për çdo aktivitet dhe këshillë të cilën Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor në Pejë e vlerëson të rëndësishme që duhet realizuar në kuadër të kësaj fushëveprimtarie;

### CILËSITË E VEÇANTA TË KËTIJ MEMORANDUMI:

Ky memorandum mirëkuptimi në tërësinë e vet shpreh mirëkuptimin e palëve lidhur me temën për çfarë lidhet. Si i tillë, për asnjërin nga palët, nuk ka për qëllim të krijojë detyrime ligjore, të krijojë asnjë të drejtë, privilegje ose përfitim për asnjë person ose palë çfarë do qofshin ato;

Të gjitha ndryshimet të këtij memorandum ndërmjet palëve të cilat mund të lindin nga interpretimi, ndryshimi apo zbatimi i cilit do aspekt të tij, mund dhe duhet të zgjidhen vetëm me konsultim reciprok e pa referencën ose përfshirjen e asnjë pale të tretë duke e përfshirë edhe gjykatën.

### KOHËZGJATJE E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT;

Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

Palët janë pajtuar që ky memorandim mirëkuptimi të jetë pa afat dhe në rast se palët e konsiderojnë të arsyeshme, secila nga ato mund të ndërpres në çdo kohë me një paralajmërim paraprak prej 30 ditësh;

E lidhur me 15. 02.2023

Palët

Për: Universitetin "Haxhi Zeqa"  
Prof. Dr. Armand Krasniqi – Rektor

Për: Shërbimi Profesional i Shëndetit  
mendor në Pejë:  
Dr. Nysret Pepaj - Drejtor